



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 qershor 2019
Nr. ref.: RK1375/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI199/18

Parashtrues

Hajriz Haxholli

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. 317/2018, të 6 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hajriz Haxholli (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Ali Latifi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Rev. nr. 317/2018] e 6 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), i cili iu dorëzua atij më 29 nëntor 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 57 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit [nr. 03/L-121] për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 dhjetor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 17 janar 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 6 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ka punuar si mësimdhënës në një shkollë fillore “Ramiz Sadiku” në fshatin Marevc dhe më pas në një tjetër shkollë fillore “Dituria” në fshatin Shkabaj.
10. Më 23 gusht 2013, Drejtoria e Arsimit pranë Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: Drejtoria e Arsimit), përmes Vendimit [nr. 03118-12848] të 23 gushtit 2013 e njoftoi parashtruesin e kërkesës se për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare, marrëdhënia e punës do t’i përfundojë më 23 gusht 2013. Kjo e fundit paraqet datën e pensionimit të parashtruesit të kërkesës.
11. Më 30 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Drejtoria e Arsimit që t’i paguhen pagat jubilarë për përcjellje në pension. Kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës e kishte bazuar në nenet 42, 43 dhe 44 të Kontratës Kolektive. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës u refuzua dhe si rrjedhojë, ai nuk pranon kompensimin e kërkuar.
12. Duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk arriti të fitojë të drejtën për kompensimin jubilar të kërkuar pranë organeve administrative të Drejtorisë së Arsimit, ai paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), duke kërkuar që të detyrohet Drejtoria e Arsimit t’ia njoh kompensimin e dy pagave jubilarë si dhe dy pagave mujore përcjellëse për shkak të pensionimit.
13. Më 12 nëntor 2014, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 2313/13], refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Si arsye për refuzim të kërkesëpadisë Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi se neni 4.1 i Kontratës Kolektive parasheh që kjo kontratë vlen për të gjithë të punësuarit dhe punëdhënësit të paraparë me nenin 3 të Kontratës Kolektive, mirëpo asnjë dispozitë e Kontratës Kolektive *“nuk ka ndonjë normë që ka përkufizuar periudhën kohore të kohëzgjatjes së kontratës, dhe nuk ka asnjë dispozitë me të cilën do të rregullohej çështja e obligimeve të marra deri në nënshkrimin e kontratës së re [...]”*. Më tutje, Gjykata Themelore theksoi se parashtruesit të kërkesës nuk iu është njohur e drejta për paga jubilarë dhe për përcjellje në pension përmes Vendimit për Pensionim të 23 gushtit 2013 sikurse që disa të paditura të tjera ia kanë njohur të pensionuarve në arsim. Si përfundim, Gjykata Themelore theksoi se kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet si e pabazuar duke qenë se Kontrata Kolektive e vitit 2005 ka skaduar në kuptim të nenit 6.4 të Ligjit nr. 2001/27.
14. Kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes së të drejtës materiale dhe asaj procedurale si dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

15. Më 21 qershor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [AC. nr. 2387/18], refuzoi ankesën e parashtruesit si të pathemeltë dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 2313/13] e 12 nëntorit 2014 të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit e arsyetoi pabazueshmërinë e ankesës nisur nga fakti se, sipas saj, Gjykata Themelore e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit në mënyrë të drejtë dhe pa shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Më tutje, u konsiderua se Gjykata Themelore kishte administruar provat dhe faktet në mënyrë të drejtë dhe në tërësi si dhe kishte zbatuar të drejtën materiale në mënyrë korrekte.
16. Kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 6 nëntor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 317/2018] hodhi si të palejuar kërkesën e parashtruesit për revizion, sepse vlera e kontestit ishte nën limitin ligjor prej 3,000 euro. Gjykata Supreme theksoi se sipas paragrafit 2, të nenit 211 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), revizioni nuk është i lejuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke refuzuar kërkesën e tij për revizion si të palejuar, i ka shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenet 3, 4, 21, 22, 23, 24, 31, dhe 57 të Kushtetutës dhe të drejtën e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së.
19. Sipas parashtruesit të kërkesës Drejtoria e Arsimit “*nuk ka zbatuar nenin 90 të Ligjit të Punës dhe Kontratave Kolektive nga viti 2005-2017*”, duke shkelë kështu të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare. Në rastin konkret, sipas parashtruesit, Drejtoria e Arsimit nuk e ka zbatuar Ligjin e Punës, Kontratën Kolektive dhe liritë dhe të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.
20. Lidhur me nenin 3 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se ky nen është shkelur duke qenë se nuk po trajtohen të gjithë në mënyrë të barabartë meqë “*disa prej kolegëve të mij të cilët e kanë fituar të drejtën për shpërblim jubilar pas pensionimit, ndërsa unë me vite po e kërkoj një të drejtë të pamohueshme*”.
21. Për sa i takon vendimmarrjes nga ana e Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës thekson se ajo nuk është lëshuar në garancitë që Kushtetuta iu jep “*të gjithëve pa dallim*”. Sipas tij, Gjykata Supreme ka gabuar kur e ka hedhur kërkesën e tij për revizion si të palejuar duke u arsyetuar në vlerën e kontestit më të vogël se 3,000 euro meqë ajo nuk është lëshuar fare në pikën 4, të nenit 211 të LPK-së, ku thuhet: “*në kontestet nga marrëdhënia e punës të cilat i fillon i punësuar kundër*

vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës, revizioni gjithmonë është i lejuar. [citat nga parashtruesi i kërkesës]”. Duke refuzuar kërkesën e tij për revizion Gjykata Supreme ka vepruar në kundërshtim me pikën 4, të nenit 211 të LPK-së.

22. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim:

“[...] kërkojmë që të zbatohet ligjshmëria dhe kushtetutshmëria, Ligji i Punës, Kontrata Kolektive.

Si rasti i Gjykatës Supreme të Kosovës që thirret në nenin 211 pika 3 – që kjo dispozitë është në kundërshtim me kategorinë e kësaj moshe, duke i barazuar me kontestet tjera që nuk e kalojnë vlerën 3,000 euro u shkelen të drejtat themelore për jetë, duke ra ndesh dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Punës nenin 90 dhe Kontratën Kolektive.

Kërkojmë që ish-mësimdhënësit t’i njihet e drejta në pagat përcjellëse dhe pagat jubilarë 2+2 paga”.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata, më tej, i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

26. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 317/2018] e 6 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
27. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

28. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pas përfundimit të marrëdhënies së punës me Drejtorinë e Arsimit për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, kishte filluar procedurat administrative dhe më pas ato gjyqësore, në lidhje me kompensimin e pagave jubilarë për përcjellje në pension. Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kishin refuzuar kërkesën e tij si të pabazuar, kryesisht me arsyetimin se nuk kishte bazë ligjore për përfitimin e një të drejte të tillë dhe se Kontrata Kolektive të cilës parashtruesi i kërkesës i referohet nuk ishte në fuqi në kohën e pensionimit të parashtruesit të kërkesës. Ndërsa, Gjykata Supreme kishte refuzuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës duke u bazuar në nenin 211 të LPK-së sipas të cilit revizioni nuk është i lejuar për kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpapia nuk e kalon vlerën në të holla prej 3,000 euro. Këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës e konteston në Gjykatë, duke pretenduar se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 3, 4, 21, 22, 23, 24, 31 dhe 57 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
29. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, në substancë, parashtruesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij nuk ka pasur gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe se ai nuk është trajtuar barabartë krahasuar me disa raste të ngjashme, në të cilat, sipas tij, Gjykata ua ka njohur të drejtën të pagave mujore si shpërbllim jubilar pas pensionimit ndërkaq që ai nuk i ka pranuar ato. Sipas tij, Gjykata Supreme ka bërë

shkelje të ligjit kur ka përjashtuar nga arsyetimi i saj pikën 4, të nenit 211 të LPK-së, duke ia refuzuar kërkesën e tij për revizion si të palejuar dhe duke mos argumentuar lidhur me pretendimet e tij për shkelje të Kushtetutës dhe faktin se revizioni duhet të ishte lejuar për kategorinë e moshës së tij meqë kishte të bëjë me të drejta nga marrëdhënia e punës. Po ashtu, ai pretendon se është vendosur gabimisht që nuk është lejuar zbatimi i Ligjit të Punës dhe Kontratës Kolektive edhe në rastin e tij.

30. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve për sa i takon Kontratës Kolektive të cilës ai iu referohet dhe interpretimin e gabuar të Ligjit për Procedurën Kontestimore nga Gjykata Supreme dhe ato të instancave më të ulëta, përfshirë edhe Drejtorinë e Arsimit si organ administrativ që fillimisht ka refuzuar kërkesën e tij për kompensim të pagave. Po ashtu, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme i ka zbatuar gabimisht dispozitat e LPK-së kur e ka refuzuar kërkesën e tij për revizion si të palejuar.
31. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, rasti KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35). E vetmja mënyrë se si këto pretendime do të mund të shqyrtoheshin dhe të pranoheshin si të bazuara është rasti kur një parashtrues arrin të dëshmojë, me argumente bindëse se, në rastin e tij konkret, ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së.
32. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
33. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar

më 10 korrik 1991).

34. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare. (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës si “*të palejuar*” - në aspekt procedural dhe pa shqyrtuar meritat e kërkesës, duke u bazuar në dispozitat e LPK-së e sipas të cilave kërkesa për revizion duhet të shpallet e palejueshme në rastet kur vlera e kontestit është nën 3,000 euro.
36. Më saktësisht, Gjykata Supreme në aktvendimin e saj kishte theksuar si në vijim:

“Nga shkresat e lëndës rezulton se vlera e objektit të kontestit në këtë çështje juridike është 1.941,37 €. Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pasi e shqyrtoi lejueshmërinë e paraqitjes së këtij revizioni, gjeti se i njëjti është i palejuar”.

Sipas dispozitës së nenit 211.2 të LPK [Ligji për Procedurën Kontestimore] revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me kryerjen e ndonjë veprimi, nëse vlera e objektit të kontestit nuk i kalon shumë 3.000 €. Vlera e kontestit në pjesën e goditur është 1,941.37 €, e cila nuk kalon limitin e caktuar me ligj”.
37. Në këtë aspekt, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
38. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate tregon se ka pasur edhe raste të tjera kur është kontestuar një aktvendim i Gjykatës Supreme – sikurse ky i tanishmi - përmes së cilit ishin refuzuar si të palejuara kërkesat për revizion në të cilat vlera e kontestit ishte nën 3,000 euro. Në rastet e tilla Gjykata, sikurse në rastin e tanishëm, është fokusuar vetëm në atë se, në tërësi, a kanë përfituar parashtruesit përkatës nga një gjykim i drejtë dhe i paanshëm duke mos u lëshuar në çështje të ligjshmërisë dhe

aspekteve të interpretimit të ligjit procedural dhe material duke qenë se ingjencat e tilla janë nën juridiksionin primar të gjykatave të rregullta. Rastet e tilla, Gjykata i ka shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese ku është kontestuar një vendim i Gjykatës Supreme që kërkesën për revizion e ka refuzuar në baza procedurale si të palejueshëm: KI66/18 parashtues *Sahit Muçolli*, Aktvendim i 6 dhjetorit 2018; KI110/16 parashtues *Nebojsa Dokić*, Aktvendim i 24 marsit 2017; KI24/16 parashtues *Avdi Haziri*, Aktvendim i 4 nëntorit 2016; KI112/14 parashtues *Srboljub Krstić*, Aktvendim i 19 janarit 2015; KI84/13 parashtues *Gani, Ahmet dhe Nazmije Sopaj*, Aktvendim i 18 nëntorit 2013).

39. Gjykata më tej konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. (Shih, rasti KI63/16, parashtues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
40. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtuesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, përkatësisht në Gjykatën Supreme, të Apelit dhe atë Themelore, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm apo për barazi para ligjit. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
41. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
42. Si përfundim, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 6 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi